



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr 2748/1 Prot

Tiranë, më 20/09/2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

**DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT
DHE AFTËSIVE, DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.66, datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirim të nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” dhe shkresës me nr.1517/4 prot, datë 11.09.2023 “Njoftim për vend të lirë pune” të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Durrës, protokolluar në AKPA me nr. 2748 prot, datë 12.09.2023, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Durrës, brenda datës 20.09.2023, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Durrës.

1. Krite të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kriteria të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Bachelor” në Shkenca Juridike.
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit.
- c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

3. Dokumentet e aplikimit:

- a. letërmotivimi për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën I të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”;
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën dhe listën e notave;
- e. librezën e punës (nëse ka eksperiencë pune);
- f. çdo dokumentacion tjetër, që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- g. certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka eksperiencë pune);
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm (nëse ka eksperiencë punë).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe të jenë të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Durrës.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-s, brenda datës 28.09.2023.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë zhvillohet si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë në:
 - i. arsimimi: 20 pikë;
 - ii. njohuritë në fushën e TIK- ut: 20 pikë;
- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;
- Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.
- Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:
 - a. Ligji nr.15/2019 "Per nxitjen e punësimit";
 - b. VKM nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar;
 - c. Ligji nr. 7961 date 12/7/1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
 - d. Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
 - e. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
 - f. Legjislacioni mbi prokurimin publik.
- ii. motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
 - Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve.
 - Minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA

